

**DHUNË** është çdo përdorim me qëllim i forcës fizike apo psikologjike. Mund të jetë në formë të kanosjes ose të përfshijë përdorim të forcës, e drejtuar kah vetja, kah ndonjë person tjetër, ose kah ndonjë grup apo bashkësi. Përfundon (ose mund të përfundojë) me lëndim fizik, me vdekje, me dëm psikik, me dëmtime në zhvillim ose me humbje.

(Organizata Botërore e Shëndetësisë)



**Agresor** është ai që shkakton dhimbje fizike, ose lëndon ndjenjat. Atë mund t'ia kryejë një personi apo më shumë vetave.




Personi apo grupi të cilët agresori i lëndon janë **viktima** të dhunës.



Në shkollë viktimë e dhunës mund të jetë:

- nxënës/nxënëse
  - grup nxënësish
  - arsimtar/arsimtare ose
  - të rritur të tjerë të punësuar në shkollë
- Të gjithë ato mund të jenë agresorë.



Afishi është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet arsimtarëve të kyçur në projektin Shkolla sipas masës së fëmijëve (dimenzioni Shëndet dhe sigur) dhe ekspertëve nga Qendra për të drejtat e njeriut dhe zgjidhje të konflikteve. Në projektin morën pjesë 10 shkollat fillore: „Gjorgji Sugarev“-Manastir, „Mellina Pop-Ivanova“-Kocani, „Vesli Glevinov“-Shkup, „Sande Shkerjavski“-Kërçovë, „Jordan Haxhi KONstantinov - Xhinot“-Veles, „11 Tori“-Shkup, „Goce Delçev“-Ljalsë, „Brestivo-Bashkim“-Gostivar, „Dimitar Vlahov“-Shkup, „Krats Petkov Mislakov“-Radovish. Redaktues: Nikola Kenig, Violeta Petrovska-Bashka. Dizajni: Sašo N. Alushovski

**DHUNA** në shkollë mund të jetë FIZIKE kur ka

- pickime, gërvishtje, shplime
- vënia e nënkëmbëzës
- tërheqje me dhunë (për shembull për teshash, flokësh, pjesëve të trupit)
- të shtrënguarit e dikujt
- goditje me pjesë të trupit (p.sh., shkelmim, goditje me kokë, shuplaka, boks ose goditje në kokë me gishtërinj)
- goditje me gjësend (shembull: me shkumës, me dftar, me thupër)
- përplasje në ndonjë gjësend (shembull: në bankë, në mur, në derë)
- rrahje mes veti
- shkaktim i lëndimeve me armë të ftohtë (shembull: me thikë, me boks hekuri, me zinxhir, me thupër hekuri)
- shkaktim i lëndimeve me armë të zjarrtë (shembull: me pistoletë, me petardë)
- aktivitet tjetër i drejtuar kah shkaktimi i dhimbjes fizike apo lëndimit fizik



**DHUNA** në shkollë mund të jetë edhe PSIKIKE

- ofendim, përqeshje dhe kritikim para të tjerëve (shembull: dhënia e emrave nënçmues, të përshkruarit e karakteristikave negative...)
- përdorimi i sharjeve
- kanosje dhe frikësim
- përfitim me forcë (shembull: të holla, deklarata) dhe detyrimi me forcë (shembull: të lket prej ore, të tregohet gënjeshtër)
- injorim dhe të larguarit/refuzuarit e dikujt
- përgojime dhe tregimi i të pavërtetave për dikë
- mbajtja e armëve (shembull: thikë, boks hekuri, pistoletë)
- marrja e diçkaje të huaj pa pyetur dhe dëmtimi i diçkaje të huaj
- aktivitet tjetër i drejtuar kah lëndimi i ndjenjave

Si lloj i posaçëm i dhunës veçohet edhe **DHUNA SEKSUALE** e cila mund të paraqitet si: **SHQETËSIM seksual** ose si **KEQPËRDORIM seksual**  
Dhunë seksuale mund të kryejë

- bashkënxënës/bashkënxënëse, arsimtar/ arsimtare, drejtor/drejtoreshë ose tjetër i rritur në shkollë dhe jashtë saj
- person i gjinisë së njëjtë ose të kundërt
- person i cili as që është i vetëdijshëm që sjellja e tij/saj paraqet dhunë seksuale – me rëndësi është ajo se viktimja e përjeton sjelljen e tij/saj si dhunë seksuale

Të rriturit në shkollë **SHQETËSOJNË SEKSUALISHT** nxënës apo nxënëse kur:

- i prekin fizikisht pa nevojë dhe pa dëshirë (p.sh.: i puthin, përkëdhelin, pickojnë etj.)
- bëjnë shaka dhe përdorin fjalë me domethënie seksuale pa nevojë (p.sh.: përdorimi i sharjeve, tregimi i barsoletave me konotacion seksual)
- u shkruajnë dhe/ose u dërgojnë mesazhe me domethënie seksuale (p.sh.: mesazhe elektronike, grafitë)
- u japin komente me domethënie seksuale (p.sh.: japin komplimente për pamjen fizike)
- përdorin gjeeste me domethënie seksuale (p.sh.: tregimi i gishtit të mesëm)
- i vështrojnë fshehurazi (p.sh.: në tualet dhe në dhomën e zhveshjes, „nën fustan“)
- u fotografojnë pjesë intime të trupit
- përgojnë me domethënie seksuale (p.sh.: flasin kush kujt i pëlqen, kush është i dashuri i cilës)
- u parashirojnë pyetje për jetën e tyre intime
- u tregojnë material pornografik
- bëjnë shkelje të privatitetit (pa leje lexojnë SMS mesazhe, ditarë etj.)
- vazhdimisht i thirrin anësh pa prezencën e të tjerëve
- përdorin tjera forma të sjelljes me/ndaj nxënësve, që kanë domethënie seksuale, me të cilat shkaktojnë lëndim të dinjitetit të personit dhe/ose krijojnë mjedis armiqësor, kanosës ose poshtërues

Moshatarët **SHQETËSOJNË SEKSUALISHT** nxënës apo nxënëse kur i bëjnë të njëjtat punë që janë cekur te të rriturit, dhe në ato raste, ato janë të padëshiruar nga nxënësit të cilëve u kushtohen, të cilët në atë mënyrë shndërrohen në viktimja të dhunës seksuale.

Gjatë **KEQPËRDORIMIT SEKSUAL** fëmijët përdoren për kënaqësi seksuale të ndonjë të rrituri apo fëmije më të moshuar, gjatë së cilës fëmija-viktimitë është vënë në situatë të vështroje apo të marrë pjesë në aktivitetet seksuale.

Lloje të posaçme të dhunës janë **VANDALIZMI** dhe **MALTRETIMI NDËRMOSHATAR**.

Vandalizëm është atëherë kur me qëllim të keq dëmtohen sende ose objekte në pronë të dikujt tjetri.



Shembuj të vandalizmit janë:

- thyerja e dritareve,
- shpimi i gomave të automjeteve
- të shkruarit nëpër mure/ banka
- futja e virusit në kompjuter



Maltretim ndërmjet moshatarëve ndodh atëherë kur një nxënës ose grup nxënësish më shumë herë me qëllim lëndojnë ndonjë bashkënxënës ose bashkënxënëse i cili/e cila nuk ka fuqi ose guxim të kundërshtojë ose ta parandalojë dhunën.



**Në shkollë nuk guxon të ketë dhunë. Prandaj, duhet të paraqitet Te arsimtari/ arsimtarja, ose te pedagogu/ psikologu, ose ndonjë tjetër të rrituri në shkollë të cilëve u besohet më së shumti.**

I finansuar nga UNICEF-I